Plagosen dy policë nga grabitësit e argjendarisë në Suharekë

Nga Venhar Isufi dhe Ermir Bujupaj

22 nëntor 2023, 16:41

Shpërndaje në

Dy zyrtarë policorë janë plagosur të mërkurën në Suharekë, pasi katër të dyshuar shtinë me armë në drejtim të tyre pasi kryhen grabitje në një argjendari.

Zëdhënësi i Policisë për rajonin e Prizrenit, Shaqir Bytyqi, i tha KOHËS se grabitja me armë zjarri ka ndodhur rreth orës 15:45, e kur Policia ka dalë në vendin e ngjarjes, të dyshuarit kanë qëlluar policinë.

Ata janë jashtë rrezikut për jetë dhe gjendja e tyre shëndetësore është stabile.

"Rreth orës 16:30 kemi marrë informatën se vetura e dyshimtë është një veturë e pasagjerëve. Sapo policia ka mbërritur në vendngjarje, të dyshuarit kanë shtënë me armë zjarri në drejtim të policisë, një zyrtar policor është plagosur. Ai ka marrë trajtim mjekësor dhe është jashtë rrezikut për jetë", thuhet në njoftimin e Bytyqit.

Të dyshuarit kanë ikur nga vendi i ngjarjes.

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore, në Ferizaj, Shukri Jashari, i ka thënë KOHËS se janë duke bashkëpunuar me Policinë dhe Prokurorinë e Suharekës për identifikimin e katër të dyshuarve që kanë shtënë në drejtim të zyrtarëve policorë.

Prokuroria në Suharekë dhe Policia kanë kërkuar bashkëpunim edhe nga Komuna e Ferizajt, meqë të dyshuarit kanë ikur në drejtim të kësaj komune.

Nga Prokuroria i kanë thënë KOHËS se mund të jetë vjedhur ari në vlerë prej 250.000 eurove.

"Sipas pronarit diku rreth 250.000 euro. Nga ana e Prokurorisë nuk është bërë akoma vlerësimi pas që jemi në fazën e mbledhjes së provave", ka thënë prokurorja Ervehe Gashi.

Qazim Reka, zëdhënës i policisë për rajonin e Ferizajit, ka thënë për KOHËN se Njësia për Reagim të Shpejt, ka ngritur pika të kontrollit në hyrje dalje të Ferizajt, për të arritur tek identifikimi i personave që gjuajtën me armë zyrtarët policorë në Suharekë.

Sipas Rekes, të gjitha drejtoritë e komunave janë ngritur dhe janë në koordinim të plotë për të arritur tek arrestimi i personave që kryen grabitjen në Suharekë.

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalin tonë zyrtar në Viber

#ARGJENDARI #PLAGOSJE #POLICIA E KOSOVËS

Policia tregon çfarë ndodhi në tregun e kafshëve në Prizren
Granata në tregun e Prizrenit: 10 të lënduar, tre të dyshuar, një i arrestuar
Prishtinë, arrestohet një i dyshuar për ngacmim seksual
Zjarri në IML dyshohet se u shkaktua nga një defekt në instalimin elektrik
Tentoi t'i korruptonte policët kufitarë në Jarinjë me 10 euro, iniciohet rast ndaj të dyshuarit
Dënohet me gjobë sulmuesi i gazetarit Krasniqi në Prizren
Kapet mall i kontrabanduar në vlerë prej 25.000 eurosh

Taboola Feed



Diploma nga shtëpia, pa provime. Shihni opsionet
Studime në distancë | Search Ads | Sponsored

Ja si mund të mbani në kontroll mykun e këmbëve në kushte shtëpie
Blog | Sponsored Lexo më shumë

Mbani në kontroll Psoriasis dhe Egzemën në kushte shtëpie
Blog | Sponsored Lexo më shumë

Pllakat e reja të murit prej gome nuk kërkojnë instalim (Kërko këtu për pllaka)
Pllaka muri gome | Kërko reklama | Sponsored

Disa keshilla ne lidhje me Psoriasis
Blog | Sponsored Lexo më shumë

Treatment That Might Help You Against Knee Pain (Search Now)
Knee Pain Treatment In Mexico | Search Ads | Sponsored

TË TJERA

Theret me thikë një i mitur në Lipjan

E mitura në Ferizaj raporton babanë se e ka sulmuar seksualisht

Vetëvritet një person në Prishtinë

Digjen dy zyra në Institutin e Mjekësisë Ligjore

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!